

L I G J
Nr.9174, datë 29.1.2004

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR (FONDI I STUDIMEVE DHE I SPECIALISTËVE, V-VITI 2001)"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar (Fondi i studimeve dhe i specialistëve, V-viti 2001)".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4133, datë 20.2.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHPUNIM FINANCIAR
(Fondi i studimeve dhe i specialistëve V-viti 2001)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:
në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 5 dhjetor 2001;

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe marrësve të tjerë, që do të zgjidhen bashkërisht nga të dy Qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, një shumë financimi prej gjithsej deri në 1 022 583,76 euro (një milion e njëzet e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre 76/100 euro) për ngritjen e një fondi studimesh dhe specialistësh ("Fondi i studimeve dhe i specialistëve V").

2. Po të merren vesh Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep

mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundohej ndërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësit të shumës së financimit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvlefësohet në rast se kontrata përkatëse për financim nuk përfundohej brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premimit. Për shumën në fjalë ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2009.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është marrësja e shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratës për financim, e cila do të përfundohej sipas paragrafit 1.

Neni 3

Qeveria e Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në paragrafin 2.

Neni 4

Qeveria e Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezulton nga dhënia e shumës së financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë në datën 22.12.2003 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.